



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR

VENDIM

Nr.48, datë 28.05.2026

“PËR KRIJIMIN E QENDRËS SOCIALE DITORE, “MIDIS NESH”, BASHKIA SKRAPAR .”

Këshilli Bashkiak Skrapar në mbledhjen e datës 28.05.2026, mori në shqyrtim projektaktin e hartuar në mbështetje të pikës 2 të nenit 8, të shkronjave “b” dhe “ç” të pikës 1.1, të shkronjës “b”, të nenit 9, të nenit 24, të nenit 54, të pikave 3 dhe 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr.121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr.57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Shërbimit Social Shtetëror dhe Bashkisë Skrapar “Për zbatimin e projektit “Qendra ditore e projektit “Qendra ditore Multifunkionale për grupet në nevojë,

VENDOSI:

- 1.Krijimin e Qendrës Sociale ditore, polivalente, “Midis Nesh”, si strukture në varësi të Bashkisë Skrapar, me adresë: zona kadastrale nr.1420, nr.pasurie 6/68, rruga “Arkitekti Kasëmi, Çorovodë.
- 2.Qendra Sociale ditore, polivalente “Midis Nesh”, do të ketë një numër total prej 7 (shtatë) punonjësish.
- 3.Qendra Sociale ditore, polivalente “Midis Nesh”,do të funksionojë nga e Hëna në të Premte ora 08.00-16.00.
- 4.Organizimi i brendshëm, struktura dhe organika e Qendrës Sociale ditore polivalente, “Midis Nesh”, miratohen me urdhër të Kryetarit të Bashkisë.
- 5.Efektet financiare të këtij vendimi do të përballohen nga buxheti që do të miratohet nga programi “Programi i Fondit Social”.

Vendimi u miratua me 9 Vota pro, vota kundër - s’ka , abstenim – s’ka

Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat.

KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK
Elsa PETRITAJ

